



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-9472

Dt. 05.05.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Rafet (Dalip) Trupaj** nga Gjakova, për dhënen e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual me lokal pune në përdhesë, me etazhitet P+2, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: aplikuesëve: Rafet (Dalip) Trupaj nga Gjakova, ndërtimi i objektit të kategorisë së parë, me destinim - objekt i banimit individual me lokal pune në përdhesë, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban “Jugu A & Jugu ana Lindore” dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 07-351/01-4126 dt. 31.03.2017, të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 2638/1, Z.K. Gjakovë-Qytet, në rrugën “Ali Pashë Tepelena”, në pronësi të të lartëpërmendurit, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+2, me sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) të objektit $S=288.87 \text{ m}^2$.

Përdhesa: (Sip,Bruto): $S= 90.75 \text{ m}^2$
Kati i parë: (Sip,Bruto): $S= 99.06 \text{ m}^2$
Kati i dytë: (Sip,Bruto): $S= 99.06 \text{ m}^2$

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të banimit individual me lokal pune në përdhesë, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese “Real – PROJECT” Gjakovë.

IV. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

V. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Rafet (Dalip) Trupaj nga Gjakova, me banim në rrugën "Ali Pashë Tepelena" pn, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-9472 të datës 25.04.2017 për dhënjën e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së parë, me destinim objekt i banimit individual me lokale pune në përdhese, me etazhitet P+2, në ngastrën kadastrale me nr. 2638/1, Z.K. Gjakovë--Qytet, në rrugën "Ali Pashë Tepelena", siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 27.02.2015, të punuar nga "GEO-REJ" SHPK-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 27.02.2017 në pronësi të Rafet (Dalip) Trupaj, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikaten mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me nr. të lëndës 704/14, të datës 22.02.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore, me nr. 07-351/01-4126, të datës 31.03.2017, për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të banimit individual, me lokale pune në përdhese, në ngastren kadastrale me nr. 12638/1, ZK: Gjakovë-Qytet, të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin Sanitar me nr. 14/530/01-9430, dt. 28.04.2017, nga Inspektoriati Sanitar Komunal-Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Gjakovës.
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-a-682 të datës 27.02.2017.
7. Pëlqimin nga KEDS - Gjakovë, të datës 12.04.2017.
8. Pëlqimin nga K.R.U. "Radoniqi" Sh.A. Gjakovë, nr. 1015, dt. 07.04.2017.
9. Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, dt. 31.03.2017.
10. Vërtetimin nga K.R.M. "Çabрати", dt. 23.02.2017.
11. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Bankën Ekonomike, filiala Gjakovë me datë 03.05.2017.
12. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, ndërmarrja projektuese "Real – PROJECT" Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1152.00 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspeksionit,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çëshjte juridike


Zenel Shabani, jur. dipl.

U. D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh. e dipl. e ark.

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë Qytet
Poseduesi: 1 /1 Trupaj Rafet (Dalip)

Shk. zvog. 1: 500



Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
2638-1	-	-	Shtëpi-Ndërtesë	-	0	00	82	
	-	-	oborr	-	0	01	29	
Gjithësejtë					0	02	11	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastrë duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

VËRTETON:

[Signature]

Zona kadastrale : Gjakovë-qytet
Parcela nr. 2638-1

Gjendja kadastrale

Gjendja faktike

Gjakovë,
30.03.2017

Punoi: Fatmir Bobi tek.

Kontrollor: Durrije Berisha I.D.A.

27.02.2017
Takeometri preeqize
Auto Cad 2004

P = 1 : 500

Punoi : Driton Shllaku gjed. i licencuar

Punoi : "GEO-REJ" SH.P.K
DREJTORI